



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 283, datë 06.07.2021

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 02.04.2021,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 53 e vijues, të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e tij, nr.35, datë 28.01.2020, “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022” dhe nr.424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe në propozimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kandidatëve për në Provimin e Pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022,

V E N D O S I:

1. Në Lidhjen 1, të pikës 1, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr.138, datë 02.04.2021, “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, pas gjeneraliteteve të kandidatit, z. {...}, shtohen gjeneralitetet e kandidates, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR